



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 870/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.11.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k, nga procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-24348-02-17-2016, me objekt: “Shërbimi me roje private”, me fond limit 10.092.294,93 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.05.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurë.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k nga procedura e mësipërme e prokurimit. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurë.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k nga procedura e mësipërme e prokurimit.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Leksi Security” sh.p.k nga procedura e mësipërme e prokurimit.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Siguria” sh.p.k nga procedura e mësipërme e prokurimit.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Ankimues:

“Toni Security” sh.p.k

Rruga “Adem Jashari”, L.8, H.10, Pall.4, Ap.3
Tiranë

“Eurogjici Security” sh.p.k

Rruga “Adem Jashari”, L.8, H.10, Pall.4, Ap.3
Tiranë

“Nazeri 2000” sh.p.k

Rruga Kavajës, Qendra Condor, Kulla H, Ap.27,
Tiranë

“Leksi Security” sh.p.k

Rruga Barikadave, Pall.136, Shk.1, Ap..3, Kati 3
Tiranë

“Siguria” sh.p.k

Rruga “F.Shiroka”, Pallatet Njb Nr.7, Godina 14
Tiranë

“Safe” sh.p.k

Nj.B 11, Rr. “B.Bilota”, Kulla Hawai-Tower, Nr.17, Pazar 2, Kati 1
Tiranë

Autoriteti kontraktor:

Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit

kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar ato, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.02.2016 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.Ref-24348-02-17-2016 me objekt: “Shërbimi me roje private”, me fond limit 10.092.294,93 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.05.2016 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.

II.2. Në datën 25.05.2016 KVO-ja ka përfunduar vlerësimin në sistemin e elektronik të prokurimeve. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

Nazeri 2000	9.879.714,87 lekë, skualifikuar
Ballazhi	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Myrto Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
A-2000	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Global Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Siguria	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Eurogjici Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Snajper Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Fideus Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Oktapus	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
SSX	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Dea Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Mandi 2K	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Leksi Security	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
Safe	9.879.714,89 lekë, skualifikuar
ISA	9.879.714,90 lekë, skualifikuar
Toni Security	10.090.984,94 lekë, skualifikuar

Secili nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është skualifikuar me argumentin:

“Nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik”.

II.3. Në datën 30.05.2016 operatori ekonomik ankimues “Siguria” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Ankimuesi kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Gjithashtu pretendohet se shoqëria “Leksi Security” sh.p.k nuk plotëson kërkesën për xhiron mesatare të tre viteve të fundit.

II.3.1. Në datën 08.06.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1.Mungon e leja e përdorimit të armëve.

2.Mungon lista emërore e punonjësve.

II.3.2. Në datën 09.06.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij si dhe duke parashtruar të njëjtat pretendime për shoqërinë “Leksi Security” sh.p.k.

II.4. Në datën 30.05.2016 operatori ekonomik ankimues “Dea Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Ankimuesi kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Gjithashtu pretendohet se shoqëritë që kanë paraqitur ofertë të barabartë me shoqërinë ankimuese, certifikatat e punonjësve nuk i kanë të vlefshme.

II.4.1. Në datën 01.06.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1.Mungon e leja e përdorimit të armëve.

2.Ka paraqitur 12 nga 18 certifikata të vlefshme në bazë të kërkesave të autoritetit kontraktor.

II.4.2. Në datën 10.06.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime, si edhe në autoritetin kontraktor.

Public Health Sector

II.5. Në datën 28.05.2016 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, si dhe duke kërkuar lënien të skualifikuar të shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k, pasi ka paraqitur ofertë nën koston ligjore.

II.5.1. Në datën 01.06.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1.Mungon e leja e përdorimit të armëve.

II.5.2. Në datën 10.06.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e dhënë në përgjigjen e dhënë nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu pretendohet se shoqëria “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ofertë nën koston ligjore.

II.6. Në datën 28.05.2016 operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij si dhe duke ngritur pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6.1. Në datën 01.06.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1. Mungon e leja e përdorimit të armëve.

2. Mungon lista emërore e punonjësve.

II.6.2. Në datën 10.06.2016 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 30.05.2016 operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

II.7.1. Në datën 01.06.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1. Mungon e leja e përdorimit të armëve.

II.7.2. Në datën 10.06.2016 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.8. Në datën 30.05.2016 operatori ekonomik “Safe” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Gjithashtu pretendohet se shoqëria “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ofertë nën koston ligjore.

II.8.1. Në datën 01.06.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1. Mungon e leja e përdorimit të armëve.

2. Kontrata për shërbim të ngjashëm është më e vogël se 40% e fondit limit.

II.8.2. Në datën 10.06.2016 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e dhënë në përgjigjen e dhënë nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu pretendohet se shoqëria “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ofertë nën koston ligjore.

II.9. Në datën 31.05.2016 operatori ekonomik “Oktapus” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

II.9.1. Në datën 01.06.2016, nëpërmjet shkresës nr.86/62 prot., autoriteti i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën. Sipas autoritetit kontraktor u vendos që ankesa të mos merret parasysh pasi shoqëria nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik:

1. Mungon e leja e përdorimit të armëve.

II.9.2. Në datën 10.06.2016 operatori ekonomik “Oktapus” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e dhënë në përgjigjen e autoritetit kontraktor.

II.10. Në datën 23.06.2016 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1381/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 86/78 prot., datë 22.06.2016, bashkëngjitur dokumentacioni mbi trajtimin e ankesave dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

II.11. Në datën 14.07.2016 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin K.P.P 536/2016 si më poshtë:

1. Të mos marrë në shqyrtim themelin e ankesave të operatorëve ekonomikë “Siguria” sh.p.k, “Dea Security” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k, “Safe” sh.p.k dhe “Oktapus” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-24348-02-17-2016, me objekt: “Shërbimi me roje private”, me fond limit 10.092.294,93 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.05.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë
2. Autoriteti kontraktor të bëjë vlerësimin e ofertave në sistemin elektronik të prokurimeve, duke njoftuar ofertuesit e skualifikuar me arsyet përkatëse të skualifikimit të tyre.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

II.12. Në datën 30.07.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar elektronikisht ofertuesit për arsyet konkrete të skualifikimit të tyre.

Operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

Nuk ploteson kriteret e kapacitetit teknik;

1. mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë) si dhe
2. mungon lista emërore e punonjësve.

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ploteson kriteret e kapacitetit teknik; mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë)”.

Operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per kete procedure prokurimi;

1. Ka ofertën ekonomike nën koston minimale ligjore të detyrueshme për këtë shërbim; dhe
2. mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë)”

Operatori ekonomik “Leksi Security” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ploteson kapacitetin ligjor; Mungon fatura e AKEP-it.”

Operatori ekonomik “Siguria” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ploteson kriteret e kapacitetit teknik;

1. mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë) si dhe

2. *mungon lista emërore e Punonjësve.*”

Operatori ekonomik “Safe” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ploteson kapacitetin ekonomik financiar dhe kapacitetin teknik; U skualifikua për arsye se nga dokumentacioni i paraqitur në sistemin elektronik:

1. *mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë);*
2. *nuk ka kontratë për blerjen e armëve;*
3. *shërbimet e ngjashme janë në vlerë të vogël se përcaktimi 40 % i DST.”*

II.13. Në 01.08.2016 operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij: *“mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë) si dhe ngrihen pretendime për ofertuesit e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit*

II.13.1. Në datën 05.08.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.13.2. Në datën 15.08.2016 operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.14. Në datën 01.08.2016 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofetues të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

1. *Oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k në total është nën koston ligjore.*
2. *Operatorët ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k, “Ballazhi” sh.p.k, “Myrto Security” sh.p.k, “A 2000” sh.p.k, “Global Security” sh.p.k, “Siguria” sh.p.k, “Snajper Security” sh.p.k, “Firdeus Security” sh.p.k, “Oktapus” sh.p.k “SSX” sh.p.k, “Dea Security” sh.p.k, “Mandi 2K” sh.p.k “Leksi Security” sh.p.k, “Safe” sh.p.k dhe “International Security Albania” sh.p.k nuk disponojnë 18 certifikata punonjësish brenda afatit 4-vjeçar.*

II.14.1. Në datën 05.08.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.14.2. Në datën 15.08.2016 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.15. Në datën 01.08.2016 operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij.

II.15.1. Në datën 03.08.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.15.2. Në datën 15.08.2016 operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.16. Në datën 04.08.2016 operatori ekonomik “Leksi Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë kundërshtohet arsyeja e skualifikimit të tij nga ana e KVO-së.

II.16.1. Në datën 05.08.2016 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.16.2. Në datën 18.08.2016 operatori ekonomik “Leksi Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij. Gjithashtu pretendohet se përgjigja e autoritetit kontraktor ka mbërritur në adresën e ankimesit në datën 11.08.2016.

II.17. Në datën 03.08.2016 operatori ekonomik “Siguria” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij.

II.17.1. Në datën 05.08.2016, nëpërmjet shkresës nr.86/98 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.17.2. Në datën 18.08.2016 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij. Gjithashtu pretendohet se përgjigja e autoritetit ka mbërritur në adresën e shoqërisë “Siguria” sh.p.k në datën 11.08.2016, e provuar me dokumentacionin përkatës (vulën e Postës Shqiptare në zarfin e përgjigjes së autoritetit kontraktor).

II.18. Në datën 04.08.2016 operatori ekonomik “Safe” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij. Gjithashtu kërkon të mbetet e skualifikuar shoqëria “Nazeri 2000” sh.p.k, me argumentin se ka paraqitur ofertë nën koston ligjore.

II.18.1. Në datën 05.08.2016, nëpërmjet shkresës nr. 86/100 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.18.2. Në datën 18.08.2016 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij. Gjithashtu pretendohet se përgjigja e autoritetit ka mbërritur në adresën e shoqërisë “Siguria” sh.p.k në datën 11.08.2016, e provuar me dokumentacionin përkatës (vulën e Postës Shqiptare në zarfin e përgjigjes së autoritetit kontraktor).

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave si dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtyre ankesave

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k për skualifikimin e tij të padrejtë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas njoftimit elektronik të datës 30.07.2016 rezulton se ankimesi është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Nuk ploteson kriteret e kapacitetit teknik;

- 1. mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë) si dhe*
- 2. mungon lista emërore e punonjësve.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Toni Security” sh.p.k rezulton se është kundërshtuar arsyeja: *mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë)*

III.1.3. Në ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik rezulton se nuk është dhënë asnjë argument apo kundërshtim lidhur me arsyen e skualifikimit sipas njoftimit të datës 30.07.2016 sipas së cilës: *mungon lista emërore e punonjësve.*

III.1.4. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i ankesës i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiteti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, një prej arsyeve të skualifikimit, nuk është ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në Komisionin e Prokurimit Publik.

III.1.5. Në nenin 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2, 5, 6 dhe 7 parashikohet se:

“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2).

“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës (pika 5).”

“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor” (pika 6).

“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkëljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme” (pika 7).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k, nuk janë ndjekur shkallët e ankimimit lidhur me arsyen e skualifikimit : “*mungon lista emërore e punonjësve*”.

Në këto kushte, duke qënë se aktualisht kanë përfunduar afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, rrjedhimisht arsyet e skualifikimit të cilat nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP, nuk mund të merren në shqyrtim nga ky komision e për rrjedhim ai rezulton të ngelet i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Edhe në hipotezën se pretendimet e tjera të paraqitura pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP do të qëndronin, operatori ekonomik ankimues nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për shkaqet e skualifikimit të bëra më dije në datën 30.07.2016, të cilat nuk janë ankimuar pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP, në respekt të shkallëve të ankimimit.

Përsa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k, përsa i përket skualifikimit të tij, nuk do të merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k, sipas së cilës: “*Nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik; mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 “Për armët” (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë)*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*”, pika 2.1, gërma “b”, të dokumentave të tenderit thuhet:

“*Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

- *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;”*

III.2.2. Shtojca 5 “*Deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike*” është deklaratë e cila plotësohet nga operatorët ekonomikë. Sipas kësaj shtojce operatorët ekonomikë deklarojnë se përmbushin të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojnë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

III.2.3. Në shtojcën 9 “*Specifikimet teknike*”, të dokumentave të tenderit, rezulton se është kërkuar realizimi i shërbimit të ruajtjes me punonjës shërbimi si më poshtë:

“*Operatori ekonomik ne kryerjen e ketij shërbimi duhet te kete personel te licensuar, me lejet perkatese te leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut ne baze te Ligjit Nr. 8770 date 19.04.2001 “Per SHRSF”, te ndryshuar me Ligjin Nr. 10081 date 23.02.2009, te cilet duhet te jene te pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise, te kene radio komunikimi, radioalarm, sistem kamerash, armatim etj.*

1. *Te mbuloje te gjitha shpenzimet si paga te rojeve , sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve , shpenzimet per uniformat , armatime , nderlidhje si dhe gjithe kompesimet e tjera te njohura me ligj.*

2. *Sigurimi i rendit dhe qetesise ne objektet qe ruan, duke parandaluar demtimin e proneve se punedhenesit ose vjedhjen e saj.*

3. Te ushtroje kontroll te herepashershem te personave qe hyjne ne territorin e objekteve qe ruhen si dhe automjeteve ne territorin e saj.

4. Te kerkoje zbatimin e rregullave te percaktuara nga punedhenesi si dhe rregullore te brendshme te nxjera nga ky i fundit te cilat do te jene pjese perberese e kesaj kontrate.

5. Te informoje rregullisht shefin pergjegjes ne institucion per shkelje te konstatuara.

KERKESAT PER PERSONELIN KRYESOR

Te kete drejtues teknik te licencuar per ushtrim aktiviteti.

Te jene te pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise

Te jene te pajisur me radio komunikimi .

Te jene pajisur me armë (vërtetuar me dokument shoqëruar).

Te kete liber planizimi per marrjen dhe dorezimin e sherbimit.

Te ofrojne sallen operative per monitorimin 24 ore te sherbimeve... ”.

III.2.4. Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“ Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Në nenin 55, pika 2 të LPP-së thuhet:

“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”

III.2.5. Në nenin 23 “Specifikimet teknike” të LPP-së, pika 1, është përcaktuar: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.”*

III.2.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1, thuhet se:

“1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

III.2.7. Në përmbushje të kërkesës së mësipërme operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur shtojcën 5 ku deklarohet se: *“[...] Përmbushim të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohet nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë”.*

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve, sic parashikohet në Dokumentat Standarde të Tenderit, por kjo deklaratë nuk është shoqëruar me dokumentat e kërkuara nga autoritetit kontraktor në specifikimet teknike sipas të cilave ofertuesit duhet të vërtetojnë me dokumentacion përkatës se personeli kryesor është i pajisur me armë.

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k, në kundërshtim me angazhimin e marrë prej tij, në këtë shtojce, për përmbushjen e specifikimeve teknike, megjithëse mer përsipër se kërkesat e autoritetit kontraktor i vërteton me dokumenta të dorëzuara me këtë deklaratë, nuk ka paraqitur bashkëlidhur, autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor për personelin kryesor, sipas të cilit është kërkuar që: [...] të jenë pajisur me armë (vërtetuar me dokument shoqërues).

Pretendimi i ankimuesit “Eurogjici Security” sh.p.k nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k për ofertuesit e tjerë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. mbetet i skualifikuar në bazë të arsyetimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimit të tij në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tij të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

III.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k se “ka ofertën ekonomike nën koston minimale ligjore të detyrueshme për këtë shërbim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, ëshë parashikuar:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia (nr. i muajve)	Çmimi Njësi (për 1 muaj)	Çmimi Total	Afati
1.	5 vend-roje me 3 turne, 1 vend-roje me 1 turn.	8.5			8.5 muaj (i parashi kuar)
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Sqarime:

1. Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Shqiptare (Lekë).

Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per licensat, uniformat, paisjen me arme dhe radiomarres, pagat e rojeve, sigurimet shoqerore dhe shendetesore, si edhe detyrimet fiskale qe parashikon ligji per: **5 vend-roje me 3 turne, dhe 1 vend-roje me 1 turn.**

Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet dhe preventivi per nje roje ne muaj dhe 5 vend-roje me 3 turne ne muaj, dhe 1 vend-roje me 1 turn ne muaj, sipas tabelës së mëposhtme. (Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në koston mujore të kryerjes së shërbimit. Për këtë arsye, çmimi për njësi është për 1 muaj. Ky çmim duhet shumëzuar me 8.5 (që janë muajt total të parashikuar))

Public Health Sector

Përlllogaritja për 5 vend-roje me 3 turne dhe 1 vend-roje me 1 turn për Vitin 2016*

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek)
1	Shpenzime për pagë bazë	
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	
5	Tarifa minimale për taksë armëmbajtje, municione, mirëmbajtje armatimi, etj.	
6	Shpenzime për uniformë dhe veshëmbathje	
7	Shpenzime për ndërlidhje	
8	Shpenzime të tjera (administrative, etj.)	
9	Fitimi (%)	
	Totali i shpenzimeve për një roje/muaj	
	Totali i shpenzimeve për një vend-roje/muaj (5 roje)	

Tabela për një vendroje me një turn të parë (nga e hëna-në të premtën) është si më poshtë:

* Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur**.

Nr	Te dhenat	Vlera/Leke
1	Paga Baze	
2	Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore	
3	Totali	
4	Shpenzime armatimi	
5	Shpenzime Uniforme, Shpenzime nderlidhje	
6	Fitimi SHRSF	
7	Shuma per nje punonjes (pa TVSH)	
8	Nr. Total i Rojeve	
9	Shuma per nje muaj pa TVSH per 1.15 roje/muaj	
10	Shuma per 8.5 muaj	

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë, ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore, kostot e armatimit, mirëmbajtjes, municionit, etj.), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

III.4.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..”

III.4.3. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

III.4.4. Në VKM nr. 573, datë 03.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: “Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzetë e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”.

III.4.5. Në nenin 81 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: “Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”, ndërsa referuar nenin 87, po këtu, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e

festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj. ”

III.4.6. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim ofertën e operatorit ekonomik ”Nazeri 2000” sh.p.k. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se oferta ekonomike e shoqërisë ”Nazeri 2000” sh.p.k në total, nuk mjafton për të mbuluar shërbimin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, sic parashikohet të dokumentat e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi si më sipër cituar.

Pretendimi i operatorit ekonomik ”Nazeri 2000” sh.p.k nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P-së, mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.6. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Leksi Security” sh.p.k sipas së cilës: *“Nuk ploteson kapacitetin ligjor; Mungon fatura e AKEP-it.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”*, pika 5, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar plotësimi i kriterit si vijon:

“Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi Tiranën.”

III.6.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Leksi Security” sh.p.k rezulton se është paraqitur Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP-i me zonë mbulimi qytetin Tiranë 20 km, shoqëruar me fatura të pagimit të AKEP-it për vitin 2016.

III.6.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.6.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson*

një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, përderisa autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kërkesën për paraqitjen e faturave të AKEP-it, vlerësimi i ofertave duhet të kryhet mbështetur në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*”.

Në këto kushte autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë dhe vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë referuar kriterëve të cilat nuk janë përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, megjithëse në ofertën e ankimesit rezultojnë faturat e pagesës së AKEP-it për vitin 2016 sipas VKM nr.599, dt.23.07.2010 dhe Udhëzimit nr.28, dt.12.11.2015.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Leksi Security” sh.p.k qëndron

III.7. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Siguria” sh.p.k sipas së cilës: “*mungon lista emërore e Punonjësve*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, rezulton se është kërkuar:

”Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- *Salle operative,*
- *minimumi 18 (tetembedhjete) punonjes sherbimi te certifikuar,*
- *1(nje) pergjegjes sherbimi,*
- *1(nje) grup te gatshem, etj.*

Per kete duhet te paraqese vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut Tirane ku jepet informacioni i mesiperme i kerkuar, shoqeruar me listen emerore te punonjesve.”

III.7.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Siguria” sh.p.k rezulton se është paraqitur shkresa nr. 185/97 prot., datë 12.04.2016 me objekt: “*Vërtetim dhe performancë*”, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Sipas kësaj shkrese rezulton se shoqëria “Siguria” sh.p.k ka aktualisht ka 51 punonjës shërbimi të certifikuar, por mungon lista emërore e punonjësve.

III.7.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”

III.7.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor duhet ta konsiderojë një ofertë të vlefshme, kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik "Siguria" sh.p.k, nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për listën emërore të punonjësve të shërbimit, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."

Nëse ankimuesi do të kishte kundërshtim lidhur me kriterin në fjalë, duhet të kishte ushtruar të drejtën e tij të ankimit në autoritetin kontraktor dhe KPP sic parashikohet në nenin 63 të LPP-së.

Pretendimi i ankimuesit "Siguria" sh.p.k nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik "Siguria" sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P-së, mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.9. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik "Safe" sh.p.k sipas së cilës: "Nuk plotëson kriteret e kapacitetit teknik; mungon leja e përdorimit të armëve, në bazë të ligjit Nr. 70/2014 "Për armët" (autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë)", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në shtojcën 7 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", pika 2.1, gërma "b", të dokumentave të tenderit thuhet:

"Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;"

III.9.2. Shtojca 5 "Deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike" është deklaratë e cila plotësohet nga operatorët ekonomikë. Sipas kësaj shtojce operatorët ekonomikë deklarojnë se përmbushin të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojnë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

III.9.3. Në shtojcën 9 "Specifikimet teknike", të dokumentave të tenderit, rezulton se është kërkuar realizimi i shërbimit të ruajtjes me punonjës shërbimi si më poshtë:

"Operatori ekonomik në kryerjen e këtij shërbimi duhet të ketë personel të licensuar, me lejet perkatese të leshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut në bazë të Ligjit Nr. 8770 date

19.04.2001 “Per SHRSF“, te ndryshuar me Ligjin Nr. 10081 date 23.02.2009, te cilet duhet te jene te pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise, te kene radio komunikimi, radioalarm, sistem kamerash, armatim etj.

1. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si paga te rojeve , sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve , shpenzimet per uniformat , armatime , nderlidhje si dhe gjithe kompesimet e tjera te njohura me ligj.

2. Sigurimi i rendit dhe qetesise ne objektet qe ruan, duke parandaluar demtimin e prones se punedhenesit ose vjedhjen e saj.

3. Te ushtroje kontroll te herepashershem te personave qe hyjne ne territorin e objekteve qe ruhen si dhe automjeteve ne territorin e saj.

4. Te kerkoje zbatimin e rregullave te percaktuara nga punedhenesi si dhe rregullore te brendshme te nxjera nga ky i fundit te cilat do te jene pjese perberese e kesaj kontrate.

5. Te informoje rregullisht shefin pergjegjes ne institucion per shkelje te konstatuara.

KERKESAT PER PERSONELIN KRYESOR

Te kete drejtues teknik te licencuar per ushtrim aktiviteti.

Te jene te pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise

Te jene te pajisur me radio komunikimi .

Te jene pajisur me armë (vërtetuar me dokument shoqëruar).

Te kete liber planizimi per marrjen dhe dorezimin e sherbimit.

Te ofrojne sallen operative per monitorimin 24 ore te sherbimeve...”.

III.9.4. Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Në nenin 55, pika 2 të LPP-së thuhet:

“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”

III.9.5. Në nenin 23 “Specifikimet teknike” të LPP-së, pika 1, është përcaktuar: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e te hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.”*

III.9.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1, thuhet se:

“1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

III.9.7. Në përmbushje të kërkesës së mësipëmem operatori ekonomik “Safe” sh.p.k ka paraqitur shtojcën 5 ku deklarohet se: *“[...] Përmbushim të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me*

certifikata e dokumenta (nëse kërkohet nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë”.

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Safe” sh.p.k ka paraqitur deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve sic parashikohet në Dokumentat Standarte të Tenderit, por kjo deklaratë nuk është shoqëruar me dokumentat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike, sipas të cilave ofertuesit duhet të vërtetojnë me dokumentacion shoqërues se personeli kryesor është i pajisur me armë.

Operatori ekonomik “Safe” sh.p.k, në kundërshtim me angazhimin e marrë prej tij, në këtë shtojcë për përmbushjen e specifikimeve teknike, megjithëse merr përsipër se kërkesat e autoritetit kontraktor i vërteton me dokumenta të dorëzuara me këtë deklaratë, nuk ka paraqitur bashkëlidhur, autorizim ose dëshmi aftësie për përdorimin e armëve nga punonjësit e shoqërisë, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor për personelin kryesor, sipas të cilit është kërkuar që: [...] të jenë pajisur me armë (vërtetuar me dokument shoqërues).

Pretendimi i ankimuesit “Safe” sh.p.k nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ”Safe” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P-së, mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.11. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Safe” sh.p.k për ofertues të tjerë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.11.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.8.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. mbetet i skualifikuar në bazë të arsyetimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimit të tij në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tij të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Public Health Sector

Vendos

1. Të mos pranojë ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k, “Eurogjici Security, sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k, “Safe” sh.p.k dhe “Siguria” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-24348-02-17-2016, me objekt: “Shërbimi me roje private”, me fond limit 10.092.294,93 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.05.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Leksi Security” sh.p.k, për procedurën e prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Leksi Security” sh.p.k duke e kualifikuar këtë ofertues.

5. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Leksi Security” sh.p.k.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1853 Protokolli,
Datë 15.08.2016

Nr. 1854 Protokolli,
Datë 15.08.2016

Nr. 1856 Protokolli,
Datë 15.08.2016

Nr. 1868 Protokolli,
Datë 18.08.2016

Nr. 1869 Protokolli,
Datë 18.08.2016

Nr. 1871 Protokolli,
Datë 18.08.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku



Kryetar
Evis Shurdha